



KABINETI I KRYETARIT

Kabinet Predcednika/ Office of the Mayor

Në mbështetje të nenit 13, LIGJI NR. 03/L-040 PËR VETËQEVERISJEN
LOKALE, Kryetari i Komunës me datën 23.08.2022 mori këtë:

V E N D I M

1. ANULOHET procedura e rekrutimit me numër të referencës RN00007958 për pozitën “Zyrtar për Arkivë 3” .
2. Pozita e lartcekur është plotësuar me nëpunës civil brenda institucionit .

A r s y e t i m

Komuna e Obiliqit ka shpallur konkurs me numër të referencës RN00007958 për pozitën “Zyrtar për arkivë 3”. Kjo pozitë është e lirë nga data 14.04.2021 nga vdekja e zyrtarit për arkiv. Procedura ka filluar nga fundi i vitit 2021 dhe pasi që procedura e lartcekur është zgjatur shumë, ekzekutivi i komunës në takimin e bordit të drejtorëve kanë vendosur që të bëjnë një organizim të punëve nëpër drejtori andaj nga data 20.04.2022 pozita e zyrtarit të arkivës për shkak të rëndësisë (së pozitës) është plotësuar me dy nëpunës civil brenda institucionit : Drita Bajrami me Vendimi me Nr.II/377 të datës 21.04.2022 dhe Sala Paci me Vendimin me Nr.II/369 të datë 21.04.2022.

Ekzekutivi i komunës anulon procedurën e lartcekur / zyrtar për arkivë 3 pasi që pozita është mbuluar me nëpunës civil brenda institucionit.

Varësisht nga nevojat e institucionit pozita e lirë do të mbulohet me një titull tjetër duke u mbështetur në Rregulloren për Organizimin e Brendshëmme Nr.I-92 të dt.29.06.2022. Bazuar në atë që u tha më lartë u vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilla juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pa kënaqur mund të ushtroj ankesë në afat prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita e pranimi të vendimit në Gjykatën Kompetente.

Ti dorëzohet:
Kryetarit të Komunës,
Njësisë BNJ,
DA
Arkivit,

